



Prishtinë, 09 qershor 2008

LIDERI I AKR-SË, TAKOHET ME AMBASADORIN GJERMAN DHE ATË BRITANIK

Kryetari i Aleancës Kosova e Re, z. Behgjet Pacolli ka pritur të hënën në zyrën e tij, në dy takime të ndara, Ambasadorin e Gjermanisë, Hans – Dieter Steinbach dhe Ambasadorin Britanik, Andy Spraks.

Gjatë këtyre takimeve është diskutuar për situatën politike në vend me theks të veçantë për situatën e re që është krijuar në Kosovë pas shpalljes së Pavarësisë. Z. Pacolli ka njoftuar ambasadorët e rinj për rolin e AKR-së, si partia më e madhe opozitare. Ai konfirmoj edhe një herë gatishmërinë që AKR ka treguar në vazhdimësi për t'i qar proceset përpara, duke dhënë kontributin e vet edhe në raport me ndërtimin dhe demokratizimin e institucioneve të Shtetit të Kosovës.

Lideri i AKR-së, pasi falënderoj z. Steinbach për mbështetjen e lartë që shteti Gjerman i ka bërë Kosovës, shprehi sërish bindjen se në këtë fazë vendit tonë i duhet, domosdoshmërisht përkushtim më i madh në ngritjen dhe zhvillimin ekonomik, ngase siç tha ai **“Zhvillimi ekonomik do të forconte pozicionin e Kosovës si Shtet i Pavarur dhe mbi të gjitha do të përmirësonte gjendjen e rëndë sociale që ekziston në Kosovë”**. Z. Pacolli shtoj se, **“AKR ka ofruar një program të detajuar për mënyrën se si duhet të veprohet për ngritje më të shpejt ekonomike”**.

Ambasadori Gjerman, Hans – Dieter Steinbach, duke falënderuar për pritjen, shprehi bindjen e tij, se bashkëpunimi në mes dy vendeve do të vazhdoj edhe më tutje. Ai shtoj se Shteti Gjerman do të jetë i përkushtuar që ta ndihmoj Kosovën në vazhdimësi, veçanërisht në aspektin e ngritjes dhe zhvillimit ekonomik.

Ndërkaq, gjatë takimit me Ambasadorin Britanik, Andy Spraks, Lideri i AKR-së, z. Pacolli, uroj Ambasadorin për detyrën e re. Ai tha se sfidat që po kapërcen Kosova, gjatë gjithë kësaj përudhe të ndërtimit të Shteti, do të ishin edhe më të vështira pa mbështetjen e Britanisë dhe vendeve të tjera mike. Ai nënvizoj faktin se shqiptarët do t'i jenë gjithmonë mirënjohës Britanisë për përkushtimin dhe gatishmërinë që ka treguar ajo, në kohët e vështira për vendin tonë. **“Natyrisht respekti dhe mirënjohja që gëzoni Ju në Kosovë duhet të jetë shtytje për ta ndihmuar edhe më tutje këtë vend. Jam i bindur se Ju do të na qëndroni përkrah edhe më tutje në zhvillimin e Shteti të Kosovës”** shtoj z. Pacolli.

Ambasadori, Spraks, tha se ndihet mirë që gjendet në Kosovë edhe për faktin se gëzon respekt të veçanët në mesin e kosovarëve. Ai garantoj z. Pacollin për mbështetje dhe bashkëpunimin të mëtutjeshëm në mes të dy palëve.

